



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 757/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kushtrim Zuka, duke vendosur lidhur me apelet e Lulzim Abazi nga Ferizaji, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.860-2021, të datës 04.03.2021, me të cilat ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara apelet, Anr.757/2021 dhe Anr.758/2021, të gjitha të datës 05.03.2021, të paraqitura nga Lulzim Abazi nga Ferizaj, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet 2501Y/07R, 2522D/01R, 2522D/02D, 2507D/01R, 2507D/02R, 2514/D/01R dhe 2510D/05D në Komunën e Ferizajt dhe vendvotimet 0410D/02R dhe 0410D/03D në Komunën e Gjilanit.

A r s y e t i m

Me datë 05.03.2021, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lulzim Abazi ka paraqitur në PZAP apelet Anr.757/2021 dhe Anr.758/2021, të datës 05.03.2021, me të cilën pretendon se në vendvotimet 2501Y/07R, 2522D/01R, 2522D/02D, 2507D/01R, 2507D/02R, 2514/D/01R dhe 2510D/05D në Komunën e Ferizajt dhe vendvotimet 0410D/02R dhe 0410D/03D në Komunën e Gjilanit në formularin e numërimit të votave për kandidatët janë përshkruar gabimisht votat siç edhe shihet se votat janë përmirësuar disa herë dhe në këtë kontekst lind dyshimi i lëshimeve të mundshme dhe dëmtimi për sa i përket numrit të votave lidhur me kandidatin me numër 108, Lulzim Abazi nga Partia Demokratike e Kosovës. Këtë pretendim të më sipërm, paraqitësi i apelit thotë se vërtetohet edhe nga shikimi nga afër i formularëve të lartcekur, ku sipas ankuesit fare lehtë mund të krijohet baza për dyshimin, për të cilën ka kërkuar që në afat ligjor dhe në drejtshmërinë e garës fer e demokratike të verifikohet ky pohim i tij dhe të jepet drejtimi përmes një vendimi përkatës nga PZAP. Pretendimet e tija i ka mbështet edhe nga raportimet e komisionerëve dhe vëzhgueseve të partisë të cilët duke qenë të përfshirë drejtpërdrejt në këtë proces, kanë tërhequr vëmendjen për një parregullsi të tillë. Po ashtu, mbështetur edhe në frymën e lirisë së zgjedhjes dhe ligjit zgjedhor, ka kërkuar nga PZAP që të aprovohet kjo ankesë, dhe të bëhet rinumërimi i vendvotimeve të përshkuara më lartë.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelet vlerësoi se:

Apelet janë të pabazuara

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se apelet: Anr.757/2021 dhe Anr.758/2021, të datës 05.03.2021, të cilat për nga përmbajtja, dhe për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitësi i apeleve është kandidati për deputet Lulzim Abazi, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), prandaj Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me të cilin përcaktohet se: “ *Me qellim të lehtësimit të apeleve, kryesuesi i panelit vendim marrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e apeleve, kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos të bëjë bashkimin e apeleve që përmbajnë në vete çështjet të ngjashme dhe se ato panele të trajtohen me një vendim*” bëri bashkimin e apeleve dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apeleve në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të parashtruesit të apeleve gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apele.

Andaj, Paneli vlerësoi se apelet e parashtruara nga Lulzim Abazi, i subjektit politik PDK, nuk janë bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.757/2021 më datën 06.03.2021

Kryesues i Panelit

Zyhdë Haziri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.